


# ЦРВЕН КРСТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
# KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
# MACEDONIAN RED CROSS

# PARIMET THEMELORE TË LËVIZJES

## Humaniteti

Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe u krijua si rezultat I dëshirës për t'ju ndihmuar të plagosurve në fushë betejë dhe këtë pa kurrfarë animi si dhe që të pengojë dhe lehtësojë vuajtjen e njerëzve gjithmonë kur kjo është e mundur. Qëllimi I Lëvizjes është që të mbrojë jetën dhe shëndetin si dhe të respektojë njeriun. Ai promovon mirkuptim të ndërsjellë, miqësi, bashkëpunim dhe paqë të përhershme në mes të njerëzve.

## Paanësia

KK nuk bën diskriminim në bazë të përkatësisë kombëtare, rasës, përkatësisë fetare, klasore ose përcaktimit politik. Ai mundohet që t'I lehtësojë vuajtjet e individëve duke u nis vetëm prej nevojave të tyre, por duke iu dhënë prioritet rasteve më urgjente.

## Neutraliteti

Me qëllim që të gëzojë besimin e të gjithëve, Lëvizja nuk guxon të merr anë të natyrës politike, racore, fetare apo ideologjike.

## Pavarësia

Lëvizja është e pavarur. Shoqatat nacionale edhepse veprojnë si plotësim I shërbimeve humanitare të qeverive dhe janë lëndë e rregullimit të Legjislativës kombëtare, duhet të ruajnë autonominë e tyre me qëllim që të mund të veprojnë në cdo kohë, në pajtim me parimet e Lëvizjes.

## Shërbimi vullnetar

Kjo është lëvizje e cila në baza vullnetare ofron ndihmë, e cila nuk është e inspiruar prej përfitimeve materiale.

## Veçantia

Në një shtet mund të ketë vetëm një shoqatë kombëtare të Kryqit të Kuq ose Gjysmëhënës së Kuqe. Ajo duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe të kryejë punën e saj humanitare në të gjithë territorin e shtetit.

## Univerzaliteti

Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në të gjitha shoqatat që e përbëjnë atë ka status të njejtë, përgjegjësi dhe obligime që të ndihmohen në mënyrë të ndërsjellë dhe vepron në mbarë botën.



# PËRMBAJTJA


Koha e ndryshimeve 41
Organizimi dhe zhvillimi 46
Diseminimi 48
Veprimtaria shëndetësore-preventive 50
Dhurimi i gjakut 53
Ndihma e parë 55
Veprimtaria sociale-humanitare 57
Programi për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave 61
Informim dhe komunikim 63
Të rinjtë e Kryqit të Kuq 64
Bashkëpunimi ndërkombëtarë 66
Shërbimi për kërkim 68
Puna finansiare dhe mobilizimi I fondeve 69
Buxheti I Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë 72

# KOHA E NDRYSHIMEVE



Dr Jovan Damjanovski
Kryetar i Kryqit të Republikës së Maqedonië

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë është pjesë përbërëse e Lëvizjes dhe anëtare e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, misioni humanitar i së cilës është prijës në gjithë botën. Duke i respektuar parimet e Lëvizjes dhe duke ndërtuar integritetin e organizatës, në vitin 2006 ne kontribuam për zbutjen e vuajtjeve të njerëzve në vendin tonë të cilët ishin në nivelin e nevojës për ofrim të ndihmës. Duke respektuar axhendën për zhvillim dhe përcaktimet programore ofruam përkrahje adekuate kategorive të ndryshme të njerëzve të rrezikuar.

Aktivitetet në vitin 2006 ishin drejtuar në vlerat tani më të etabluara të organizimit tonë të cilat janë veprimtari e rregullt por u ndërmorrën edhe masa për arritjen e një shkalle më të lartë të organizimit dhe efikasitetit gjatë punës. Me qëllim të zbatimit dhe reorganizimit thelbësor të shoqatës sonë kombëtare u implementuan më shumë projekte dhe u aplikuan përmbajtje të reja të cilat kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme posacërisht të transparencës dhe efikasitetit të organizatës.

Në vitin 2006 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë bëri vlerësimin dhe analizën e punës së organizatave komunale të Kryqit të Kuq me qëllim të pasqyrimit të gjendjes dhe me qëllim që të detektohen anët e këqija dhe të mira të organizimit tonë me ndërmarrjen e masave për sendërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet e Shoqatës kombëtare dhe me qëllim që më me sukses të realizohen qëllimet e parapara dhe prioritetet në Planin zhvillimor të organizatës për periudhën 2006-2010.

Lidhja elektronike e shoqatës kombëtare, revista e re elektronike, imazhi i ri i revistës "Meridianet humane" dhe përmbajtjet në ëeb faqen tonë ofrojnë mundësi që partnerët dhe shfrytëzuesit tanë në cdo kohë të njihen me aktivitetet që organizon Kryqi i Kuq i Maqedonisë.

Aplikimi i bazave elektronike të shënimeve në organizatat komunale dhe në Qendër në pjesën e ndihmës së parë dhe dhurimin e gjakut kontribuan për implementimin më me sukses dhe më të sistematizuar të aktiviteteve të cilat ndërmirren në pajtim me Ligjin për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Viti që kaloi shënoi edhe bashkëpunimin e mrekullueshëm të Kryqit të Kuq të Maqedonisë me komponentët e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, partnerët tjerë ndërkombëtarë me të vilët realizojnë programe të përbashkëta dhe me institucionet shtetërore në Republikën e Maqedonisë.

Ne jemi të vetëdijshëm se puna jonë e suksesshme rrjedh prej angazhimeve të të gjithë vullnetarëve tanë të cilët paraqesin komponentë zhvillimore, prej anëtarëve të organizatës, udhëheqësisë, drejtorisë dhe të punësuarve, të cilëve sinqerisht iu falinderohemi për devotshmërinë e tyre dhe agazhimet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2006. Njëkohësisht dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për përkrahjen e vazhdueshme të partnerëve tanë nga vendi dhe jashtë, institucioneve qeveritare, organizatave joqeveritare, mediumeve, ndërmarrjeve, qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, Komitetit ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, Federatës ndërkombëtare dhe Shoqatave kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ne vlerësojmë se gjithmonë ka hapësirë që të bëhet pak më shumë dhe se nuk kemi arrit plotësisht të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që ofrojnë kapacitetet tona njerëzore dhe materiale por jemi të bindur se ekzistojnë të gjitha kushtet Kryqi i Kuq i RM-së të jetë një organizatë me organizim të lartë, efektive dhe bashkëkohore e cila aktivitetet e saj i organizon sipas të gjitha standardeve botërore dhe se paraqet partner të barabartë me të gjitha pjesët e Lëvizjes ndërkombëtare. Në këtë drejtim na arsyetojnë rezultatet që arritëm me moton se kjo është koha e ndryshimeve që na vë në një pozitë të përgjegjshme për angazhime të reja për përshtatjen tonë me kushtet bashkëkohore të veprimit.



Sait Saiti
u.d, Sekretar gjeneral i Kryqit të Kuq së Republikeë së Maqedonisë

# VITI 2006 NË PËLLËMBË



## JANAR



- U botua publikimi i raportit vjetor të punës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2005 në të cilin ishin përfshirë aktivitetet e implementuara nëpër të gjitha veprimtaritë e shoqatës kombëtare.
- U aprovua programi i punës i Qendrës për diseminim dhe komunikim

## SHKURT



- U aplikua bashkëpunimi me të rinjtë e Kryqit të Kuq finlandez dhe u realizuan dy vizita të delegacioneve të të rinjve në Finlandë dhe Maqedoni.
- Kryqi i Kuq i Baden Virtembergut të Gjermanisë i cili 15 vite në kontinuitet siguron ndihmë humanitare për Maqedoninë donoi ndihmë për institucionet shëndetësore dhe sociale në vend.
- U organizuan puntori për bazë vlerësuese të përbashkët me organizatat komunale të Kryqit të Kuq të RM-së të cilët implementojnë Projektin për zhvillim të përbashkët të shoqërisë. .

## MARS



- Prej 17 Marsit u shënua Java e luftës kundër kancerit nëpërmjet të më shumë aktiviteteve të organizatave komunale.
- U shënua Dita e dhurimit të gjakut dhe Dita e formimit të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë- 17 Marsi.
- Filloi publikimi javor i Revistës elektronike të Kryqit të Kuq të RM-së e cila përmban aktualitete për aktivitetet javore të realizuara i cili dërgohet në 30 000 e mail adresa.

## PRILL




- Filloi projekti për kryerjen e vlerësimit dhe analizimit të punës së organizatave komunale të Kryqit të Kuq në Republikën e Maqedonisë.
- Një përfaqësues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë mori pjesë në mbledhjen për koordinator nacional për menaxhim me katastrofat që u organizua në Caftat, Kroaci.
- Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim me Ministrinë e vetqeverisjes lokale dhe NJBVL organizuan tre seminare për përfaqësues të 86 e njësive të vetqeverisjes lokale në vend.
- U shënua Dita botërore e shëndetësisë

## MAJ



- Një përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së mori pjesë në mbledhjen vjetore të Shoqatave nacionale evropiane për bashkëpunim për ndërmarrjen e aktiviteteve rreth tregtimit me njerëz, në Caftat-Kroaci.
- U organizua stërvitje e ekipeve për përgjigje regjionale gjatë atastrofave.
- U organizua një kurs veror dhe dimëror për shpëtues në male.
- U organizua stërvitje për shërbimin profesional në qendrën e KKRMS për informim dhe komunikim.
- U organizua një seminar me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të Kuq për implementimin e Planit zhvillimor të Kryqit të Ku të RM-së për periudhën 2006-2010.

## QERSHOR



- U organizuan mbledhjet statutare të Lëvizjes prej 8-23 qershor në Zhenevë me crast u aprovua amblemi i ri i Lëvizjes (Kristali i kuq) që mundësoi pranimin e shoqatave kombëtare të Izraleit dhe Palestinës në Federatën ndërkombëtare.
- U shënua 14 qershori - Dita botërore e dhurimit të gjakut.
- U organizuan gara nga ndihma e parë.
- KKRM mori pjesë në garat europiane të ndihmës së parë që u mbajtën në Asisi, Itali.
- U shënua Java e solidaritetit - 01-01 qershor
- Doli numri i ri i revistës së KKRM - "Meridianet humane"

## KORRIK



- U përgadit një doracak për ndihmën e parë psikologjike dhe përkrahjen gjatë streseve, traumave dhe katastrofave
- U mbajt aksion tradicional i dhurimit të gjakut me rastin e përvjetorit të tërmetit të Shkupit të vitit 1963.
- U bënë përgaditjet për implementinim e projektit: ngritja e vetëdijes publike të rinia shkollore për vetmbrojtje dhe mbrojtje në rast të katastrofave. U realizuan takime me ministrine për arsim dhe shkencë

## GUSHT



- U realizua kampi ndërkombëtarë i rinisë "Miqësia pa kufinj", në periudhën prej 18- 25 gusht në Qendrën e KKRM-së në Strugë dhe në të morën pjesë rreth dyzet pjesëmarrës nga Maqedonia, Sërbia, Kosova, Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina dhe Norvegjia.
- Gjatë periudhës prej 28 gusht deri 3 shtator u organizua Kampi ndërkombëtar i të rinjve "Të jemi një dhe të punojmë bashkë" në Strugë, Maqedoni. Në këtë kamp morën pjesë 34 të rinj vullnetarë prej gjashtë shoqatave kombëtare nga Finlanda, Suedia, Spanja, Italia, Polonia dhe Maqedonia.
- U rrumbullaksua projekti për vlerësimin dhe analizën e organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM-së.

## SHTATOR



- U shënua Dita botërore e ndihmës së parë - 2 shtatori.
- U shënua Java e luftës kundër tuberkulozit- 14 - 21 shtator
- Projekti "Promovimi i vlerave humane" si model i ri i diseminimit për të rinjtë filloi të implementohet në të gjitha organizatat komunale të Kryqit të Kuq.
- U organizua stërvitja regjionale "Paqësori 2006" në liqenin e Tikveshit, Kavadar.
- U botua Doracaku për të rinj "Hap pas hapi"
- Përfaqësues të KKRM-së morën pjesë në Kuvendin e ERNA

## TETOR



- U organizua kampanja me rastin e "Ditës së urisë" me shumë aktivitete në të gjitha organizatat komunale të Kryqit të Kuq për sigurimin e ndihmës materiale dhe finansiare për banorët me gjendje sociale të rrezikuar.
- U organizuan zgjedhje të jashtëzakonshme te të rinjtë e Kryqit të Kuq në të gjitha nivelet e organizimit
- U shënua Java e të rinjve të Kryqit të Kuq- 01-07 tetor.
- Përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së mori pjesë në Kuvendin vjetor të Rrjetit europian të shoqatave kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe për ndihmë të parë në Zhenevë, Zvicërr.

## NËNTOR




- Qeveria e Republikës së Maqedonisë e pranoi iniciativën e Kryqit të Kuq të RM-së për forminim e Komitetit kombëtarë për DNH në RM me seli në lokalet e KKRM-së.
- U aplikua hulumtimi i opinionit publik për imazhin e KKRM-së.
- U shënua Dita botërore e sëmundjeve kronike obstruktive të mushkërive të bardha.
- U botua doracak për edukimin e motivuesve për dhurimin e gjakut.
- U shënua java e kujdesit për persona të moshuar - 20-26 nëntor.
- KKRM mori pjesë në Konferencën regjionale për përgaditjen e strategjisë për ndërtimin e lidhjeve familjare ne Kiev, Ukrainë.

## DHJETOR



- U organizuan puntori me student për promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare.
- U shënua java e luftës kundër SIDA- 01-07 dhjetor
- U botua publikimi i Programit për punë të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2007.
- Një delegacion i Kryqit të Kuq të Maqedonisë mori pjesë në Konferencën e 15 ballkanike të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe e cila u organizua nga Gjysmëhëna e kuqe turke në Marmaris, Turqi.

# Të arriturat g

## Organizimi dhe zhvillimi

Është kryer vlerësimi dhe analiza e punës së organizatave komunale të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në bazë të së cilës janë aprovuar masa për veprim të Shoqatës Kombëtare me qëllim të sendërtimit të kapaciteteve të organizatës.

Si rezultat i numrit të madh të stërvitjeve dhe seminareve të mbajtura gjatë vitit kalendarik, është shtuar numri i vullnetarëve dhe të punë-suarve të trajnuar si parakusht i rëndësishëm për përforcimin dhe sendërtimin e kapaciteteve të Shoqatës Kombëtare.

## Veprimtaria shëndetësore preventive

Janë bërë hapa të rëndësishëm për aplikimin e vlerësimit shëndetësorë gjatë planifikimit të aktiviteteve për gatishmëri dhe vlerësim gjatë katastro-fave.

Është zbatuar edukim i ekipeve lokale për punë në fushën e zvoglimit të dëmeve nga shfrytëzimi i drogave. KKRM filloi aktivitetet të cilat nëpërmjet të punës së drejtpërdrejtë me grupet qëllimore do të kontribuojë për ruajtjen e pranisë së ultë të HIV në Maqedoni.

## Ndihma e parë

Pjesëmarrja e suksesshme e shoqatës sonë nacionale në garat nacionale nga ndihma e parë dhe zënja e vëndit të 16, më e lartë deri tani.

U punua një bazë kompjuterike për azhurimin e të dhënave të kandi-datëve për shofer të automjeteve që i nënshtrohen provimit nga ndihma e parë.

## Diseminimi

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e pranoj iniciativën e Kryqit të Kuq të RM-së për formimin e Komitetit Kombëtar për të drejtën ndërkombëtare human-itare në RM me seli në lokalet e Kryqit të Kuq të RM i cili filloi të funksionoj nga fundi i muajit nëntorë të vitit 2006.

Projekti "Promovimi i vlerave humane" si model i ri i diseminimit të të rinjëve implementohet nëpër të gjitha organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

## Dhurimi i gjakut

Përgatitja e bazës kompjuterike për të dhëna për azhurimin e dhuruesve të gjakut.

U botua doracaku për motivues në fushën e dhurimit të gjakut.

## Veprimtaria sociale humanitare

The Programme "Participatory Community DProgrami për "Zhvillim të përbashkët të bashkësisë" u implementua me sukses nëpërmjet të organizatave komunale të Kryqit të Kuq - Karposh, Kavadarit dhe Tetovës. Gjithsejt 13 OBKK tani më janë aftë-suar për aplikimin e metodës për vlerësim të shpejt unik të nevojave të bashkësive të rrezikuara.

Është përgatitur doracak për Ndihmë të parë psikologjike për nevojat e organi-zatave komunale të Kryqit të Kuq.

Në të ardhmen doracaku do të paraqet kornizë thelbësore për përfitimin e shkathtësive për ballafaqim me strese dhe trauma të grupeve të ndryshme qëllimore.

# gjatë vitit 2006

## Bashkëpunimi ndërkombëtarë

Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq norvegjez i cili është një ndër donatorët kryesor të KKRM-së është avancuar dhe është paralajmëruar përkrahje financiare për vitin 2007. Si rezultat i të arriturave të mira në KKRM, Kryqi i Kuq belg ka shpreh gatishmëri dhe interes për përkrahje të aktiviteteve të KKRM-së në vitin 2007.

Është realizuar bashkëpunim i rregullt dhe i shkëlqyeshëm me shoqatat kombëtare nga Europa qendrore nëpër fusha të ndryshme programore.

## Informimi dhe komunikimi

Me qëllim që në të ardhmen të shëndrrohet në botim i cili do t'i dedikohet opinionit më të gjërë dhe do të paraqet burim të mjeteve plotësuese finansiare për Kryqin e Kuq të RM-së, gjatë vitit 2006 u bë ndryshimi i emrit dhe konceptit të revistës të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë i cili botohet me emrin "Meridiane humane".

Me aplikimin e mënyrës së re elektronike të komunikimit në shoqatën kombëtare, u hapën mundësi të shumta për afirmimin e aktiviteteve të Kryqit të Kuq të RM-së në rrugë elektronike. Prej vitit 2006 Kryqi i Kuq i RM-së përgadit revistë elektronike e cila një herë në javë përcjell aktivitetet e organizatës deri te 30 mijë shfrytëzues të internetit në vend dhe jashtë tij.

## Programi për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq norvegjez dhe me përkrahjen e Ministrisë për arsim dhe shkencë inicuan projektin për ngritjen e ndërgjegjes së opinionit tek rinia shkollore për mbrojtje dhe vetmbrojtje në rast të katastrofave.

U aftësuan 28 profesorë të shkollave të mesme në Shkup ndërsa projekti vazhdon me implementimin në tërë shtetin gjatë vitit 2007.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe - Delegacioni regjional në Budapest në maj të vitit 2006 organizuan trajnim të anëtarëve të rinj (vlerësues në rast të katastrofave) të Ekipit regjional për përgjigje gjatë katastrofave. Stërvitja përfshiu dyzet e pesë përfaqësues të shoqatave kombëtare nga Europa Juglindore dhe Azia Qendrore.

## Të rinjtë e kk

Janë realizuar dy kampe ndërkombëtare ndërsa është avansuar edhe bashkëpunimi i të rinjve me 12 shoqata ndërkombëtare.

Është shtypur doracak për organizimin e të rinjve.

## Puna finansiare dhe mobilizimi i fondeve

Avancimi i mënyrës së përgaditjes së buxhetit për vitin 2006 i cili përmban pasqyrë gjithpërfshirëse të punës së gjithmbarshme të KKRM-së si dhe avansimi i mënyrës dhe sistemit të planifikimit dhe informimit si dhe zbatimit të revizionit të pavarur të jashtëm për punën materialo-finansiare gjatë vitit 2005.

Është kryer edhe edukimi i sekretarëve i OTHKK -së për menaxhim finansiar.

## Shërbimi për kërkim

Ka filluar procedura për zhvillimin e Strategjisë për "Krijimin e lidhjeve familjare" me perspektivë më afatgjate për zhvillim të kapaciteteve të Shërbimit për Kërkim në shoqatat kombëtare me qëllim të ballafaqimit me nevojat e grupeve të rrezikuara në shoqëri.

# ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI



Për zbatim të sukseshëm të misionit, vizionit dhe të vlerave humane të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2006 aplikoi aktivitete programore të sistematizuara të cilat dalin prej kahjeve dhe prioriteteve strategjike të parapara me Planin Zhvillimor të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për periiudhen 2006-2010 të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënes së kuqe.

Gjatë vitit, organet dhe trupat e Kryqit të kuq të RM, punuan në pajtim me kahjet programore dhe me dokumentet tjera të aprovuara. Kuvendi i Kryqit të kuq i RM, mbajti dy mbledhje të rregullta, Këshilli ekzekutiv i Kryqit të kuq të RM mbajtën 7 mbledhje ndërsa komisionet dhe trupat e punës gjatë vitit 2006 mbajtën 18 mbledhje. Si rezultat i kësaj pune në mbledhjet e Kuvendit dhe Këshillit ekzekutiv të Kryqit të kuq të RM, gjatë vitit 2006 u aprovuan dhe sollën: 67 vendime, aprovime dhe 9 rregullore.

Numri i madh i stërvitjeve dhe seminareve gjatë vitit kalendarik paraqesin bazë për numrin e madh të vullnetarëve dhe punëtorëve të edukuar si parakusht i rëndësishëm për përforcimin e kapaciteteve të shoqatës kombëtare.

Gjatë vitit 2006 u organizuan dhe mbajtën: 12 seminare, 2 kampe të të rinjve, 3 takime punuese me sekretarët e organizatave komunale dhe të qytetit të Kryqit të Kuq dhe një takim punues me kryetarët e organizatave komunale dhe të qytetit të Kryqit të Kuq.

Gjatë muajit maj dhe tetor, me përkrahjen e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Kryqi i Kuq i Maqedonisë organizoi dy seminare me sekretarët dhe kryetarët e organizatave komunale të Kryqit të Kuq me temë: implementimi i planit zhvillimot të Kryqit të Kuq të RM-së për periudhën 2006-2010. përfaqësues të udhëheqësisë dhe drejtorisë të shoqatës sonë kombëtare këmbyen disa përvoja në raport me implementimin praktik të planit zhvillimor dhe nevojën e sendërtimit të ndryshimeve të qëllimeve prioritare të caktuara me dokumentin strategjik në drejtim të avancimit dhe zhvillimit të punës së shoqatës kombëtare.

Përfaqësues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë mori pjesë në kursin për stërvitje zhvillim organizativ i cili u mbajt në periudhën prej 2 deri 6 tetor 2006 në Budapest, Hungari.

Përmbajtjet kryesore që u trajtuan dhe diskutuan gjatë stërvitjes pesë ditore ishin ardhmëria e Federatës dhe agjenda globale, organizimi i shoqatave kombëtare, planifikimi, monitorimi dhe implementimi në nviel lokal, cështjet institucionale dhe baza ligjore e organizatave komunale udhëheqja me kuadro në nivel komunal, vullnetarizmi, zbatimi i vlerësimit dhe analizës në nivel komunal.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në kontinuitet ka pasë përkrahje për sendërtimin e kapaciteteve nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Kryqi i Kuq norvegjez.

# VLERËSIMI DHE ANALIZA

## E PUNËS SË ORGANIZATAVE KOMUNALE TË KRYQIT TË KUQ NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË










Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në kuadër të angazhimeve për transformim efikas, reorganizim dhe sendërtim të kapaciteteve të shoqatës kombëtare, ndërrmori më shumë aktivitete për modernizimin e punës. Me punën transparente dhe informimin me kohë, me aplikimin e sistemit komunikues efikas të brendshëm dhe jashtë si dhe me stërvitjen e kuadrit vullnetarë dhe profesional dhe sendërtimin e kapaciteteve materiale-teknike të organizatës, u arrit një përmirësim i imazhit të shoqatës kombëtare.

Gjatë periudhës së kaluar u aplikuan më shumë forma të punës me qëllim të përmirësimit të performancave të shoqatës kombëtare u inicua dhe përgadit një projekt për vlerësim dhe analizë të punës së organizatave komunale të KKRM-së dhe organizatës së Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit ndërsa i njejti u mbështet me finansa nga ana e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe - delegacionit regjional ne Budapest. Qëllimi i projektit ishte të bëhet vlerësimi dhe analiza e gjendjes aktuale në organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe në Kryqin e Kuq të qytetit të Shkupit si dhe të caktohen rekomandimet për përkrahje të mëtutjeshme organizatave komunale. Përfundimet që dolën si rezultat i vlerësimeve dhe rekomandimeve të gjithmbarshme do të paraqesin bazë për transformim dhe reorganizim efikas të të gjitha segmenteve të shoqatës kombëtare.

Prej vlerësimeve përfundimtare të përmbajtura në dokument dalin masa konkrete të cilat më tutje duhet ndërrmarë nga ana e Kryqit të Kuq të RM-së me qëllim të tejkalimit të dobësive të caktuara gjatë punës së organizatave komunale të Kryqit të Kuq. Në drejtim të përmirësimit të gjendjes duhet angazhuar për përgaditjen e programeve dhe projekteve në pajtim me nevojat e organizatave të Kryqit të Kuq në nivel të qytetit dhe komunave, përmirësim të kapaciteteve të komunikimit dhe ofrimit të raporteve deri te Kryqit i Kuq i RM-së; stërvitje permanente të drejtorisë së organizatave komunale, aplikimit të formave të reja për tërhjekejen e vullnetarëve; stimulimin e bashkëpunimit ndërkomunal për implementimin e aktiviteteve programore dhe ndërtimin e raporteve dhe bashkëpunimit në baza të partneritetit me OJQ, institucionet qeveritare dhe vetqeverisjen lokale dhe monitorim permanent dhe evaluim të organizatave komunale të Kryqit të Kuq.

Në bazë të vlerësimit dhe analizës së kryer, kah fundi i vitit 2006 u zbatua edhe vlerësimi i aktiviteteve programore sipas veprimtarive të organizatave komunale të KKRM-së e cila do të rezultojë me propozime dhe masa konkrete për avancimin e kapaciteteve dhe përmbajtjeve për veprim të shoqatës kombëtare në tërësi gjatë periudhës që pason.

# DISEMINIMI







Në pajtim me programin vjetor të punës për diseminim që implementohet në bashkëpunim me Komitetitn ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq janë realizuar këto aktivitete:

Diseminuesit e organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe organizata e Kryqit të Kuq e qytetit të Shkupit, cdo muaj kanë kryer sesione diseminimi nëpër komuna duke përcaktuar grupet qëllimore të dëgjuesve dhe varësisht prej kësaj kanë mbajt prezentime prej përmbajtjeve programore për diseminim. Diseminuesit me ligjeratat e tyre kanë marrë pjesë në disa seminare të organizuara nga shoqata kombëtare.

Gjatë vitit janë mbajt katër mbledhje regjionale me të punësuarit dhe diseminuesit (Shtip, Prilep, Ohër dhe Shkup), në të cilat është prezentuar raporti për evaluim të programit për diseminim i përgaditur për periudhën 2002-2005.

Me qëllim të hulumtimit të përdorimit (keqpërdorimit) të amblemit të Kryqit të Kuq në RM u detektuan disa probleme, u përcaktuan detyrat dhe u përgadit një koncept për realizimin e aktiviteteve, mënyra, koha, metodat dhe teknikat me përshkrim të efekteve dhe rezultateve. Përvec takimeve punuese dhe marrëveshjeve u realizua edhe një takim me sekretarët e OBKK në Strugë për zbatimin e hulumtimit për përdorimin (keqpërdorimin) e amblemit. Është me rëndësi se u angazhuam për pasqyrimin dhe zbatimin e mjeteve që do të shërbejnë për hulumtim dhe shfrytëzim më qenësor, përdorimi dhe keqpërdorimi i amblemit dhe shfrytëzimi i Kryqit të Kuq të RM-së për qëllime zhvillimore formale dhe faktike. Kryqi i Kuq i RM-së kah fundi i muajit nëntor dhe fillimi i muajit dhjetor (23 dhe 30.11 dhe 05.12) organizoi tre puntori një ditore me temë "E drejta ndërkombëtare humanitare". Në këto puntori morën pjesë gjithsejt dyzet e tetë studentë të fakultetit juridik të universitetit "Sh. Kirili dhe Metodij"- Shkup, institutit për punë dhe politikë sociale, institutit për studime të mbrojtjes dhe paqësore, të unversitetit të Europës - Shkup dhe Universitetit të Europës Juglindore- Tetovë. Nëpërmjet të ushtrimeve interaktive, detyrave grupore, prezentimeve dhe video klipeve, u prezentuan aktivitetet e e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Kryqit të Kuq të RM-së me theks të vecantë te të drejtat e njeriut dhe e drejta humanitare. Me këto puntori filloi programi i të rinjve të Kryqit të Kuq për promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare në RM. Shënimi i 8 majit - Ditës botërore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Këtë vit shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe ditën e vet e shënuan me moton: "Ndihma univerzale nëpërmjet të vullnetarizmit", me aktivitete të Lëvizjes ndërkombëtare. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqednisë e shënoi edhe javën e Kryqit të Kuq, 8-15 maj, aksion tradicional i paraparë me Ligjin për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë. Për këtë qëllim u përgaditën pllakate të cilat u distribuuan deri te organizatat komunale të Kryqit të Kuq ndërsa u publikua edhe një pullë postale me pagesë. Me këtë rast në Republikën e Maqedonisë përvec shënimit qëndror, u organizua edhe një numër i madh i aktiviteteve nga ana e organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe nga Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit.

**Qendra për diseminim dhe komunikim.** Qendra paraqet burim themelor të informatave për aktivitetet dhe efektet humanitare, komunikim me vullnetarët dhe subjektet tjera të interesuara, hapësirë për kreacionet e aktiviteteve dhe resurseve për materiale dhe literaturë për diseminim e cila funksionon sipas programit të hartuar që:

- Janë bërë prezentime nga ana e të punësuarve sipas veprimtarive prej shërbimeve profesionale të grupit qëllimor- të rinjtë e Kryqit të Kuq nga OBKK e qytetit të Shkupit;
- Janë organizuar mbledhje të komisioneve, takime punuese dhe kurse trajnimi me të punësuarit dhe vullnetarët e inkuadruar në projekte të caktuara.
- Janë shënuar aktivitete tradicionale të Kryqit të Kuq;
- Janë distribuar materiale promovuese;

Për nevojat e qendrës për diseminim dhe komunikim janë shtypur këto materiale:

- Broshurë e Kryqit të Kuq të RM-së- "Misioni permanent humanitar";
- Broshura - "Historia e Kryqit të Kuq"
- Flajera për të rinjtë e Kryqit të Kuq;
- Kalendar për vitin 2007;



**Promovimi i vlerave humanitare -** model i ri për diseminimin për të rinjtë. Projekti Kryqi i Kuq në aksion - promovimi i vlerave humane ( KKA-PVH) për shoqatën kombëtare paraqet model të ri për diseminim për të rinjtë, gjegjësisht mjet interaktiv nëpërmjet të të cilit lidhet diseminimi me praktikën humanitare, Kryqi i Kuq me nxënësit /vullnetarë të rinj dhe njohuritë e kërkuara me aksion në jetën e vërtetë. Për të rinjtë, për vullnetarët ose për vullnetarët e ardhshëm kjo ishte shansë që të bëjnë dicka që të ndryshojnë ose përmirësojnë mjedisin në të cilin jetojnë duke ndërtuar dhe zhvilluar veten e tyre si individ të pjekur dhe të ndërgjegjshëm të cilët i nevojiten Shoqatës sonë kombëtare. Për vitin 2006/07, nëpërmjet të modelit të ri për zgjerimin e programit nëpër të gjitha OBKK-të, që është aprovuar prej Këshillit ekzekutiv të Republikës së Maqedonisë pritet që 1 200 të rinj të kalojnë stërvitjen për kulturë, kounikim, diseminim, për përgaditjen dhe dokumentimin e projekteve si dhe të hartojnë rreth 200 projekte..

**Komiteti kombëtarë për implementimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare në RM.** Iniciativa e Kryqit të Kuq e RM-së për formimin e një trupi në mes të resorëve të ndryshëm për diseminim dhe implementim të së drejtës Ndërkombëtare Humanitare në Republikën e Maqedonisë u pranua dhe aprovua në muajin qershor të vitit 2006 me Vendim të qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në pajtim me këtë vendim, qeveria e RM-së në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të RM-së formoi Komitet kombëtarë për të drejtën Humanitare Ndërkombëtare me seli në lokalet e Kryqit të Kuq. Në përbërje të Komitetit kombëtarë janë përfaqësues të sekretariatit gjeneral të qeverisë, Ministrisë së kulturës, Ministrisë së drejtësisë, Ministrisë së mbrojtjes, Ministrisë së punëve të jashtme, Ministrië së arsimit dhe shkencës dhe Ministrisë së shëndetësisë dhe Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë.

Mbledhja e parë konsultative e Komitetit kombëtarë u mbajt më 27 nëntor 2006 në lokalet e Kryqit të Kuq të RM-së. Për kryetarë të Komitetit u emërua Goran Stevcevski nga Ministria e punëve të jashtme, për zëvendës kryesues u emërua Prof.Dr Vladimir Ortakovski, vullnetar i Kryqit të Kuq dhe anëtar i Komisionit për diseminim dhe hartues i studimit për implementimin e DNH-së në RM.

**Trupi këshilldhënës për hulumtim të DNH-së** - Komiteti ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq dhe Byroja për zhvillim të arsimit në RM në dhjetor të vitit 2004 nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim me crast u formua trup këshilldhënës për hulumtimin e DNH-së. Në punën e këtij trupi u inkuadruan përfaqësues të Byrosë, KNKK-së dhe Kryqit të Kuq të RM-së. Trupi këshilldhënës i programit për Hulumtimin e të Drejtës Humanitare (HDH) u takua në muajin tetor me qëllim të shqyrtimit të adaptimit final të versionit të shkurtë të HDH-së dhe të shqyrtojë planin e mëtutjeshëm të aktiviteteve për procesin e integrimit të HDH-së. Njëkohësisht trupi këshilldhënës përkrahu mbajtjen e stërvitjes për trajnuesit për programin të cilin gjatë vitit 2007 do ta zbatojnë duke trajnuar 330 arsimtarë të lëndës Kultura Qytetare.

**Hulumtimi i opinionit publik për imazhin e Kryqit të Kuq në RM.** Këto sandazhe i realizoi agjencioni i autorizuar BRIMA GALLUP, nëpërmjet të anketimit telefonik të 800 të anketuarve dhe punës praktike me dy grupe fokus me crast u hartua një Raport dhe Analizë. Të dhënat prej hulumtimit flasin për informimin e qytetarëve për Kryqin e Kuq të RM-së dhe aktivitetet që i kryen me kahjet ku duhet në të ardhmen fokusuar shoqata kombëtare me qëllim të ofrimit të shërbimeve popullatës dhe me qëllim të promovimit të saj.



# VEPRIMTARIA SHËNDETËSORE PREVENTIVE

Aktivitetet në planin e veprimtarisë shëndetësore preventive të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u zhvilluan në pajtim me Planin zhvillimor 2006-2010 dhe programin vjetor të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2006.

**Preventiva ndaj HIV/SIDA.** Gjatë vitit u implementua projekti për preventivë ndaj HIV/SIDA te grupet e rrezikuara, i përkrahur nga ana e donatorit "Partneritet për shëndet". Rekomandimet që dolën pas përfundimit të projektit përfshijnë kahjet për zhvillim të mëtutjeshëm të aktiviteteve preventive për HIV nëpër organizatat komunale të Kryqit të Kuq ndaj grupeve të caktuara qëllimore: punëtorë transporti, punëtorë komercial seksual, të burgosur etj.

Projekti për preventivë ndaj HIV dhe infeksioneve që barten përmes seksit (IBS) te të rinjtë.







Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në teren u mbajt mbledhje një ditore në të cilën morën pjesë 21të rinj prej të cilëve 17 të stërvitur më parë për edukim të të rinjve dhe që kishin marrë pjesë në realizimin e këtyre aktiviteteve nëpër shkollat fillore dhe të mesme në mjediset e tyre. Me këtë rast u analizua numri i pier edukatorëve dhe numri i shkollave fillore dhe të mesme. U prezentua një tabelë për planifikimin e edukimit në shkolla e cila deri në fillim të vitit duhet dërguar në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe e cila do të përmbajë planet e OBKK-së për semestrin e dytë gjatë vitit shkollor 2006/07. Gjithashtu u siguruan dhe distribuan 3000 prezervativë dedikuar edukimit të moshatarëve për HIV dhe IBS.

**Shënimi i Javës së luftës kundër SIDA** Këtë vit Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë u inkuadrua në kampanjën globale të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe me moton: "Afrohu...HIV nuk mund të fitosh me...". Qëllimi i kampanjës ishte të realizohen aktivitete të cilat kontribuojnë për zvogëlimin e stigmës dhe diskriminimit ndaj njerëzve që jetojnë me HIV/SIDA në bashkësi. Në nivel nacional Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë shtypi gjithsejt 2000 postera. Me përkrahjen e Federatës ndërkombëtare u siguruan mjete për përkrahjen ë përkrahje të kampanjës në OBKK dhe furnizimit me 6 000 prezervativa që u distribuan gjatë Javës.

Në nivel lokal u përkrahën OBKK Manastir, Prilep, Veles, Demir Hisar, Kavadar dhe KK i qytetit të Shkupit i cili e organizoi manifestimin qendror në kryeqytet. Manifestimi qen-

dror u mbajt në sheshin Maqedonia në të cilin u organizua marshi i llampadarëve me pjesëmarrje të 400 të rinjve, 15 miqëve të KK-së si dhe kalimtarëve të rastit. Me këtë rast u realizua një konkurs letrar ndërsa 3 vendet e para u shpërblyen me dhurata ndërsa fragmentet u lexuan gjatë programit të rastit të organizuar pas marshit të llampadarëve.

Ky program përfshin edhe prezentimin e muzikantëve të njohur nga Maqedonia. Kjo ngjarje u përcoll prej mediumeve të vendit. OBKK- Shtip, Kratovë, Ohër dhe Kocan u inkuadruan në aktivitetet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Aktivitetet e planifikuara të SHK ishin drejtuar



kah zvogëlimi i stigmës dhe diskriminimit ndaj njerëzve të cilët jetojnë me HIV/SIDA në bashkësitë tona. Aktivitetin "Parada e llampadarëve" këtë vit e organizuan 7 organizata komunale të Kryqit të Kuq dhe morën pjesë 1 680 vullnetarë të rinj ndërsa me puntori edukative, ligjerata dhe tribuna u përfshin mbi 840 të rinj. Të gjitha aktivitetet u zbatuan me sukses në nivel kombëtarë dhe lokal me crast edhe një herë u dëshmua rëndësia e aktiviteteve të Kryqit të Kuq dhe rëndësia e tyre për bashkësinë.

**Projekti për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave.** Me iniciativë të 3 OBKK filloi programi për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave në Kërcovë, Veles dhe Prilep. Projekti u përkrah prej KK italian nëpërmjet të Federatës ndërkombëtare dhe fondacionit "Instituti shoqëria e hapur, Maqedonia". Për qëllimet e realizimit të këtij projekti, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë nënshkroi marrëveshje për bashkëpunim me OJQ HOPS. Në bazë të kritereve të definuara paraprakisht, secila OBKK formoi ekipe prej 5 vullnetarëve prej të cilëve njëri u emërua koordinator i ekipit. Në bashkëpunim me OJQ HOPS u organizua stërvitje me punë praktike me njësitë e terenit të kësaj OJQ në Shkup. Në stërvitje si ligjerues mori pjesë edhe Dr.Sinisha Zovko, themelues dhe koordinator i programit për zvogëlimin e dëmeve prej KK kroat dhe ligjerues i përhershëm në stërvitjet e fondacionit Villa Maraini të KK italian.

Gjithsesi seminari i vlerësuar lart dhe kontribuoi për fillimin e susesshëm të tri projekteve në OBKK gjatë muajit dhjetor. Ky projekt u prezentua para vullnetarëve të vetqeverisjes lokale, MPB, shtëpive të shëndetit dhe institucioneve tjera relevante dhe kontribuoi për sendërtimin e imazhit të aktiviteteve të KK ndaj grupeve qëllimore.

**Shënimi i Javës së luftës kundër Tuberkulozës e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, 14 deri 21 shtator.** Këtë vit moto e kampanjës ishte "Bota pa tuberkulozë" ndërsa qëllimi ishte të tregohet veprim partneriteti për pengimin e kësaj sëmundjeje. U hartuan dhe shtypën postere në 1 330 ekzemplarë dhe një pullë postale. Gjatë kësaj jave dy përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së morën pjesë në Kuvendin vjetor të Rrjetit evropian të Shoqatave kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe për luftë kundër HIV/SIDA, tuberkulozi dhe zvogëlimi i




dëmeve nga përdorimi i drogave (ERNA), ku Shoqata jonë kombëtare fitoi një shpërblim nderi për devotshmërinë dhe shfrytëzimin e qasjeve të reja gjatë punës në fushën e tuberkulozit. Gjatë javës organizatat komunale të Kryqit të Kuq realizuan shumë aktivitete si ligjerime edukimi nëpër organizatat arsiomore, emisione dhe biseda nëpër mediat lokale, dërgimit të apeleve deri te mjekët e mbrojtjes primare shëndetësore për udhëzimin për ekzaminim të të gjithë pacientëve që tregojnë simptome të tuberkulozit dhe të DAT -shërbimit pneumoftiziologjik, tribunave dhe diskutimeve publike, distribuimit të pakove me ushqim, artikujve higjienik dhe veshmbathjeve për familjet me gjendje të rëndë sociale të prekur nga tuberkulozi,

në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore, ligjerime edukimi për grupe specifike qëllimore për zvogëlimin e rrezikut nga sëmundjet, ekzaminimit të tyre dhe kahjeve për trajtim të mëtutjeshëm. Shënimi i ditës botërore së sëmundjeve kronike obstruktive të mushkërive të bardha (SKOMB) që u organizua nën patronatin e BOEHRINGER Ingelheim Pharma GMBH-përfaqëisa në Maqedoni, shoqatës respiratore maqedone dhe Kryqit të Kuq të Maqedonisë, ndërsa në bashkëpunim me: komunat Cair dhe Karposh, klinikës së pulmologjisë, spitalit special të sëmundjeve të mushkërive - Jasenovë, spitalit ushtarak, Institutit të sëmundjeve të mushkërive dhe TBC dhe Institutit të mjeksisë së punës. Qëllimi i kampanjës ishte ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e SKOMB -it, faktorët e rrezikut dhe shërimi me moton: "Nëse mbeteni pa frymë, nuk jeni pa ndihmë". Grupi qëllimor përfshinte: persona të moshuar, persona mbi 40 vjecar që kolliten, lodhen shpejtë dhe marrin frymë rëndë gjatë aktiviteteve fizike, që janë ose kanë qenë duhanxhinj.

Aktivitetet përfshijnë kontrollë spirometrike dhe konsultim me mjekë.  Gjatë një dite u kryen mbi 1 000 kontrollime ndërsa tek 50% e të kontrolluarve u ekzaminua fazë e avancuar e SKOMB-it.





## Shënimi i javës kundër kancerit e Kryqit të Kuq të RM-së, 1-7 mars.

Me këtë rast u shtypën dhe distribuuan deri te OBKK 1 300 postere si dhe 100 mijë pulla vetëngjitëse. Moto e javës ishte " Kontrollimi i rregullt -shëndet i  mirë". Materiali propagandues u distribuua në të gjitha komunat në Republikë ndërsa qëllimi kryesorë i kampanjës ishte ngritja e ndërgjegjes tek gratë për kontrollime të rregullta dhe përmirësim i shëndetit të tyre.

## Shëndeti publik në kushte të katastrofave

Me këtë rast u hartua një pyetsor për vlerësimin e aspektit shëndetësor të katastofave. Ky është mjet ndihmës i Njësisë për gatishmëri gjatë katastrofave dhe ka për qëllim të mundësojë sigurimin e informatave për shëndetin e banorëve të prekur dhe kapacitetit të shërbimeve të mundshme shëndetësore me qëllim që të mund të planifikohet përgjigjja adekuate për bashkëpunim me institucionet relevante dhe kompetente..

# DHURIMI I GJAKUT



Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2006, me realizimin e 48.043 dhurimeve vullnetare të gjakut, obligimet e planifikuara i plotësoi me 82.32%.

Rezultatet e dhurimit të gjakut në vitin 2006 krahasuar me rezultatet e vitit 2005 janë më të dobëta për 5.046 njësi gjaku ose për 8.65%

Në qytetin e Shkupit në vitin 2006 u realizuan 10.232 njësi gjaku ose plani u plotësua me 62.56% që në krahasim me vitin e kaluar rezultatet janë më të dobëta për 1.051 njësi gjaku.

Obligimet e planifikuara i realizuan 15 organizata komunale të Kryqit të Kuq: Vallandova 11240%, Velesi 14972%, Vinica 240.91%, Dellceva 11240%, Kavadari 124.40%, Kocani 100.14%, Kratova 119.27%, Kriva Pallanka 122.84%, Krusheva 219.55%, Negotina 101.01%, Ohri 127.21%, Shën Nikolla 115.40%, Shtipi 234.45%, Gazi Baba 100.07% dhe Qendra 116.82%.

Shtatë organizata komunale të Kryqit të Kuq e realizuan planin për dhurimin e gjakut në vitin 2006 nën 50%. Këto janë organizatat komunale të Kryqit të Kuq: Gostivari 37.99%, Kërcov 42.40%, Kumanova 42.54%, Radovishi 47.76%, Tetova 35.05%, Karposhi 38.96% dhe Kisela Voda 30.89%.

Gjatë vitit 2006 në fushën e dhurimit të gjakut në krahasim me vitin 2005 rezultate më të mira shënojnë organizatat komunale të Kryqit të Kuq nga Velesi, Gostivari, Kratova, Ohri, Struga, Tetova dhe Shtipi, ndërsa rezultate më të dobëta shënohen në Berovë, Manastir, Makedonski Brod, Vallandovë, Vinicë, Gjevgjeli, Demir Hisar, Dibër, Dellcevë, Kërcovë, Kriva Pallankë, Krushevë, Kumanovë, Negotinë, Prilep, Probishtip, Radovish, Resnje, SHën Nikollë, Strumicë, Gazi Babë, Karposh, Qendër, Kisella Vodë dhe Cair.

Gjatë vitit 2006 në repartin për mjekësi transfuziologjike të Spitalit ushtarak në Shkup u realizuan gjithsejt 2 374 njësi gjaku që krahasuar me vitin 2005 kur u realizuan 3 543 njësi gjaku, u shënuan rezultate më të dobëta për 1 169 njësi gjaku. Programi për organizim dhe avansim të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë për vitin 2006 u soll në mbledhjen e qeverisë së Republikës së Maqedonisë ndërsa në fletën zyrtare u publikua më 30 mars të vitit 2006.




Me rastin e 17 marsit, ditës së dhurimit të gjakut, më 16 mars të vitit 2006 në lokalet e Ministrisë së shëndetësisë, ministri i shëndetësisë pranoi një delegacion dhjetë anëtarësh të Kryqit të Kuq të RM-së. Në këtë takim u bë fjalë për rezultatet e arritura dhe për problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë realizimit të programit për dhurimin e gjakut. Të njëjtën ditë në lokalet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u organizua një press konferencë.

Më 17 mars të vitit 2006 në Shtëpinë e ARM-së në Shkup u mbajt mbledhje solemne e Kuvendit të Kryqit të Kuq të Maqedonisë në të cilën kryetari i Kryqit të Kuq të RM-së Dr.Jovan Damjanovski iu ndau dhurata tre organizatave komunale të Kryqit të Kuq që zunë vendet e para gjatë vitit 2005 në fushën e dhurimit të gjakut dhe pllaketa 22 OBKK-ve të cilat plotësuan planin për dhurimin e gjakut gjatë vitit 2005. Me këtë rast u organizua një tribinë për dhurimin e gjakut e titulluar "Dhurimi i gjakut në periudhën tranzitore dhe konceptet e reja për avancimin e tij".

Gjatë muajit mars të vitit 2006 u përgaditën dhe

ndanë mirënjohje jubilare për dhuruesit e shumëfishtë. Me aktivitete të ndryshme në formë të mbledhjeve solemne, takimeve me dhurues të gjakut dhe darka të dhuruesve, OBKK në këtë mënyrë shënoi 17 marsin, Ditën e dhuruesve të gjakut në Republikën e Maqedonisë.

Më 14 Mars 2006 në SHOH "Dare Xhambaz" u organizua Aksioni memorial për dhurimin e gjakut kushtuar kryetarit të ndjerë Boris Trajkovski në të cilin dhuruan gjak 68 qytetarë prej Shkupi dhe mysafirë dhurues të gjakut prej vendlindjes së Trajkovskit nga Strumica.

Më 14 Qershor 2006 u shënua Dita botërore e dhurimit të gjakut me moton: " Të festojmë dhurimin e gjakut". Në parkun para platosë së shtëpisë së armatës në Shkup u shënua Manifestimi qëndror më 14 Korrik, në organizim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, OQ të Kryqit të Kuq të Shkupit ndërsa nikoqir ishte OBKK -Çair. Me këtë rast u organizua edhe aksion për dhurimin e gjakut. Për këtë manifestim u shtypën 5.000 flaera.

Aktivitete të ngjaJshme me rastin e shënimit të 14 Korrikut, Ditës botërore të dhurimit të gjakut u organizuan edhe prej më shumë organizatave komunale të Kryqit të kuq, në mes të cilave e Velesit, Valandovës, Kocanës etj.

Gjatë muajve Korrik dhe Gusht të vitit 2006 u përgatitën plane operative të Organizatave Komunale të Kryqit të kuq dhe u organizuan më së paku nga një deri dy aksione për dhurimin e gjakut.

Gjatë muajve të verës, korrik dhe gusht, u bënë



angazhime shtesë për aksione të jashtëzakonshme për dhurimin e gjakut. Në pajtim me Programin për organizim dhe avansim të dhurimit të gjakut, u furnizuam me stilolapsa kushtuar dhuruesve.

Gjatë muajit Nëntor të vitit 2006 u shtyp Doracaku për edukimin e motivuesve për dhurimin e gjakut në 1500 egzemplarë ndërsa për shtqpjen e tij u siguruan mjete finansiare prej projektit të Kryqit të kuq Norvegjez.

Gjatë muajit Dhjetor të vitit 2006 , Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, në Strugë organizoi seminar për edukimin e motivuesve të dhuruesve. Në këtë seminar morën pjesë 32 përfaqësues të OBKK, në mes të cilëve mysafirë nga Kryqi i kuq shqiptar, bullgar dhe serb. Gjatë seminarit u promovua Doracaku për edukim të motivuesve të dhuruesve nga ana e Prim. Dr. Risto Dukovski, drejtor i ERT në Shkup.

Gjatë muajit dhjetor të vitit 2006 u përgadit dhe doli nga shtypi pllakat i ri për caktimin e aksioneve për dhurimin e gjakut.

Gjatë vitit në të gjithë shoqatën kombëtare të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u instalua program kompjuterik për evidentimin e dhuruesve dhe me këtë qëllim të punësuarit që punojnë në këtë problematikë u edukuan ndërsa dhjetra OBKK që nuk posedojnë mjete adekuate iu ndanë kompjuter.

Mjetet për vitin 2006 sipas programit për organizimin dhe avansimin e dhurimit të gjakut u siguruan nga Ministria e shëndetësisë e RM-së.

Gjatë vitit 2006 u realizua një bashkëpunim i mirë me Entin republikan për transfuziologji dhe me shërbime tjera për transfuziologji.

Në përgjithsi me rezultatet e arritura gjatë vitit 2006 nuk mund të jemi të kënaqur sepse në 25 OBKK ka dështim në rezultate në krahasim me vitet e mëparshme. Gjatë 12 viteve të kaluara, prej vitit 1995 dhe përfundimisht me vitin 2006 në Republikën e Maqedonisë janë shënuar rezultate më të dobëta në fushën e dhurimit të gjakut. Kjo tregon se është e nevojshme një analizë profesionale për problemet me të cilat po ballafaqohemi dhe të propozojmë masa dhe aktivitete pë përmirësimin e rezultateve.

Për arritjen e rezultateve më të mira në vendin tonë në planin e dhurimit të gjakut nevojiten angazhime shtesë nga ana e OBKK-së, aplikimin e formave dhe metodave të reja të punës me grupe të ndryshme qëllimore dhe sigurimin e gjakut të sigurtë me një motivim të jashtëzakonshëm dhe përgjegjsi të personelit të punësuar dhe vullnetarëve.



# NDIHMA E PARË

Aktivitetet në planin e ndihmës së parë të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u zhvilluan në pajtim me Planin zhvillimor 2006-2010 dhe programin vjetor për vitin 2006 të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

## Kurset nga ndihma e parë për kandidatët për shoferë të automjeteve.

Aktivitetet e rregullta realizoheshin në të gjitha 34 organizatat komunale të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. U aftësuan mbi 20 mijë shoferë të ardhshëm të automjeteve. Dëgjuesit e mësimit morën nga një doracak për ndihmën e parë të botuar nga Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ndërsa pas mbarimit me sukses të kursit morën edhe vërtetime adekuate. Për arsimimin e tyre u inkuadruan më shumë se 300 punëtorë shëndetësorë nga tërë vendi të cilët punën e tyre profesionale e kryen me sukses dhe kontribuan për përfitimin e shkathtësive elementare nga ndihma e parë. Mësimi përfshinte elementet themelore të ndihmës së parë por theks i vecantë në mënyrë tradicionale u vu mbi aplikimin praktik të ushtrimeve. Shumica e këtyre ushtrimeve janë të rëndësishme për ruajtjen e jetës dhe zvogëlimin e pasojave nga lëndimet e shkaktuara dhe përvec tjerash përfshin: ofrimin e ndihmës së parë të lënduarit në vendin e aksidentit, kontrollimin e shenjave të jetës, mënyrën e ndalimit të gjakderdhjes, ndihmën e parë tek lendimet mekanike etj.

## Shënimi i Ditës botërore të Ndihmës së Parë

Dita botërore e ndihmës së parë u shënua me moton: "Shpëtoni jetë pa diskriminim, bëhuni vullnetarë i Kryqit të Kuq". Qëllimi kryesor me këtë rast ishte që theks i vecantë të bie mbi efektet pozitive të cilat ndihma e parë i ka në jetën e



përditshme por edhe në kushte të katastrofave, fatkeqsive dhe gjatë preventivës prej sëmundjeve. Me rastin e shënimit të kësaj dite u zbatuan shumë aktivitete. U shtyp një poster i cili u distribua deri te Organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të qytetit të Shkupit u punua nje fllaer i cili u distribua në revistën "Tea Moderna" si dhe në manifestimin qendror. Në organizim të Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit u realizua manifestimi qendror në sheshin Maqedonia me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e ndihmës së parë. U organizuan pesë punkte në të cilat gjatë tërë kohës ofrohej ndihma e parë. Nga ana e organizatave komunale u realizuan aktivitete të shumta: ligjerata për ndihmën e parë, prezentim dhe demonstrim për ofrimin e ndihmës së parë, kfize nga ndihma e parë, edukim për kategoritë e rrezikuara të njerëzve, paraqitje të përfaqësuesve të Kryqit të Kuq në mediume distribuim të materialit propagandues dhe rëndësia e Ndihmës së parë, konferencë tematike për risitë nga ndihma e parë për punëtorët shëndetësorë.

## Organizimi dhe realizimi i garave nga ndihma e parë e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë cdo vit në mënyrë tradicionale organizon gara nga ndihma e parë për kategoritë e të rinjëve, gjegjësisht për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Në organizim të Organizatave komunale të kryqit të Kuq u organizuan gara vec e vec në dy kategori ndërsa fituesit morën pjesë në garat regjionale gjejgësisht ato shtetërore. Në garat shtetërore morën pjesë tri ekipe që u plasuan në vëndet e para në garat regjionale nga ndihma e parë.

Gara e parë regjionale u mbajt në Veles më 27. 05. 2006 në të cilen morën pjesë ekipe të OBKK nga: Valandova, Velesi, Vinica, Gjevgjelia, Karposhi, Kocana, Kriva Pallanka, Krusheva, Kumanova, Negotina, Strumica dhe Shtipi.

Gara e dytë regjionale u mbajt në Gostivar më 03. 06. 2006 në të cilën morën pjesë ekipe të OBKK nga: Manastiri, Gazi Baba, Gostivari, Kavadari, Kisella Voda, Kercova, Ohri, Prilepi, Resnja, Struga, Tetova, Qendra dhe Çairi.

Garat shtetërore u mbajten në Ohër më 12. 06. 2006. Në këto gara morën pjesë ekipe të OBKK nga: Manastiri, Velesi, Gjevgjelia, Karposhi, K. Voda, Negotina, Prolepi, Strumica dhe Çairi.

Fitues në kategorinë e më të rinjëve ishin: OBKK Karposh - vëndi i parë, OBKK Prilep - vëndi i dytë dhe OBKK Strumicë - vëndi i tretë.

Fitues në kategorinë e të rinjëve ishin: OBKK Karposh - vëndi i parë, OBKK Kisella Vodë - vëndi i dytë dhe OBKK Negotinë - vëndi i tretë.



Në këto gara në mënyrë reviale morën pjesë edhe : ekipi në kategorinë e të rinjëve të OBKK të Gjevgjelisë e cila e përfaqësoi Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë në Garat evropiane nga ndihma e parë gjatë vitit 2006 dhe ekipi i kategorisë së të rinjëve e Kryqit të kuq e qytetit të Shkupit e cila këtë e përfaqësoi në Kampionatin Ballkanik të ndihmës së parë. Pjesëmarrësve me këtë rast iu ndanë diploma ndërsa tri ekipeve të plasuara në vëndet e para edhe kupa.

## Pjesëmarrja në Garat evropiane të ndihmës së parë në Asisi, Itali

Garat evropiane nga ndihma e parë u mbajten prej 15 deri 18 qershor 2006 në qytetin Asisi në Itali. Në këto gara morën pjesë 26 ekipe. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë e zuri vëndin e 16.

## Kuvendi vjetor i Rrjetit evropian të Shoqatave kombëtare të Kryqit të Kuq/ Gjysmëhënës së Kuqe nga ndihma e parë - Zhenevë, Zvicërr- Tetovë 2006.

Kuvendi vjetor kishte rëndësi të posacme sepse u shënua manifestimi i 15 vjetorit të ekzistimit të Rrjetit edukativ europian nga ndihma e parë, dhjetë vjetori i ekzistimit të Qendrës referente europiane për ndihmë të parë dhe Sertifikatit europian për ndihmë të parë.



# VEPRIMTARIA SOCIALE-HUMANITARE

Në pajtim me përcaktimet programore për veprim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në planin e veprimtarisë sociale - humanitare gjatë vitit 2006 u implementuan aksione dhe aktivitete të rëndësishme për ofrimin e ndihmës dhe kujdesit për banorët në vendin tonë si dhe programe zhvillimore për avansimin e metodologjisë së punës së personave të angazhuar në këtë plan në organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

## Ndihma dhe kujdesi ndaj popullatës së rrezikuar, ndihma për institucionet sociale, shëndetësore etj.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë gjatë vitit të kaluar realizoi bashkëpunim me shoqatat tjera kombëtare, organizata joqeveritare si dhe organizata tjera me qëllim të sigurimit të llojit të caktuar të donacioneve për përkrahje të aksioneve humanitare të Kryqit të Kuq.





Duhet shënuar bashkëpunimi i begatshëm pesë vjeçar me Kryqin e Kuq gjerman- organizata krahinore e BADEN Virtenbergut e cila në kontinuitet realizohet prej vitit 1992 deri sot. Gjatë muajit shkurt dhe korrik përfaqësues të Kryqit të Kuq gjerman të Baden Virtenbergut e vizituan Kryqin e Kuq të Maqedonisë. Gjatë qëndrimit të tyre u vizituan OBKK Negotinë, Cair, Vinicë dhe Berovë si dhe disa institucione sociale dhe shëndetësore. Gjatë vitit dy herë u dhurua ndihmë humanitare për Maqedoni. E para në vlerë prej 29.450 euro dhe e dyta prej 43.750 euro (shtretër, karroca për invalid, rollatorë, kompjuter etj). dhe e njejta u distribua për entet dhe qendrat shëndetësore dhe sociale si dhe për nevojat e OBKK-së për realizimin e aktiviteteve programore.

Nga ana e Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim pranë qeverisë së RM-së u sigurua ndihmë prej katër mijë kg detergjent dedikuar nevojave të personave të shpërngulur në Shkup dhe Kumanovë. Kompania COLGATE siguroi donacion prej 1 500 brushave për dhëmbë dhe e njejta iu dorëzua organizatës së Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit për zbatimin e programit për mbrojtje shëndetësore preventive. Gjithashtu u ndanë edhe 350 copë të veshmbathjeve të reja të siguruara nga një firmë private.

Në bashkëpunim me agjencionin adventistik për zhvillim dhe ndihmë ADRA nga Gjermania për herë të dytë në kuadër të projektit "Fëmijtë iu ndihmojnë fëmijve", u ndanë 2150 pako për Vit të Ri dhe 520 pako me veshmbathje në vlerë prej 6900 euro. Me rastin e festave të Vitit të Ri organizatat komunale të Kryqit të Kuq pakot iu ndanë fëmijëve me nevoja të posacme si dhe fëmijëve të familjeve në gjendje të vështirë sociale. Më 28 dhjetor një përfaqësues i ADRA mori pjesë gjatë distribuimit të ndihmës humanitare.



## Aktivitetet tradicionale

Aksionet tradicionale dhe aktivitetet e planit social-humanitar në pajtim me kalendarin e Kryqit të Kuq të Maqedonisë edhe gjatë vitit të kaluar u shënuan me aktivitete programore të rastit.




Prej 1 -7 korrik u shënua "Java e solidaritetit" me moton: "Vepro që të ndjehesh mirë- ndihmo!" Me këtë moto onrganizatat komunale realizuan aktivitete të rastit kushtuar solidaritetit të qytetarëve. Për këtë javë u përgaditën materiale informative-edukative: flaera në 20 mijë ekzemplarë, 1 300 pllakate, 100 mijë pulla pa nominim si dhe u përgaditën ligjerata të tipizuara kushtuar të rinjve nëpër institucionet edukativo-arsimore. Në bashkëpunim me Postat e Maqedonisë u botua pullë rasti me vlerë në 200 mijë ekzemplarë. Në kuadër të javës nëpërmjet të organizatave komunale të Kryqit të Kuq u organizua edhe aksion grumullues të të mirave materiale me të cilën u siguruan gjithsejt: 15 451 kg ushqim, veshmbathje, mjete të higjienës dhe të njejtat iu ndanë banorëve të varfër.

**Me rastin e 16 tetorit "Ditës së urisë" u organizua një kampanjë me moton "Mendoni edhe për ne".** Bartës të aktiviteteve të cilat u realizuan në kuadër të javës prej 16 deri 22 tetor ishin të rinjtë e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Komisionet për veprimtari sociale-humanitare. Për promovimin e aktiviteteve u përgadit një spot TV ndërsa nëpërmjet të mediumeve opinioni u inofmua për qëllimin e kampanjës. Gjithashtu u hartua edhe material promovues: 2000 pllakate, 18000 fllajera, 2000 copë gota të cajit dhe triska me vleftë nominale. Me rastin e kampanjës nga ana e organizatave komunale të Kryqit të Kuq u organizuan aksione dhe aktivitete humanitare të rastit me qëllim të sigurohet ndihmë në të holla dhe ushqim për individ që kanë nevojë për ndihmë të këtillë (aksione grumbullimi, sigurimin e shujtave të ngrohta, sigurim të ushqimit, aukcion të veprave të artit, shitja e bruмërave shtëpiake dhe veprave të artizanatit, punëtori kreative të të rinjve, aksione të shitjeve humanitare). Në kampanjë prej aksioneve të realizuara nëpërmjet të organi-




zatave komunale u grumbulluan gjithsejt 924.523.00 den dedikuar për ndihmë banorëve të varfër.

Prej 20-26 nëntor me aktivitete programore të rastit u shënua "Java e kujdesit për njerëzit e moshuar" me moton "Jeni të rëndësishëm për ne". Për promovimin e aktiviteteve u shtyp një pllakat prej 1 300 ekzemplarëve, 100 mijë pullave panominale për edukimin e të rinjve u përgadit një fllaer me përmbajtje të rastit një 20 mijë ekzemplar si dhe u përgadit një ligjeratë tipizuese. Gjatë javës u promovuan aktivitetet nëpërmjet të mediumeve elektronike dhe të shkruara. Me përkrahjen e dy kompanive u siguruan 10 City Light lokacione në qytetin e Shkupit në të cilat u promovua pllakati dhe u paralajmërua vetë java. Nëpërmjet të organizatave komunale të Kryqit të Kuq u realizuan më shumë aktivitete: vizita në shtëpitë për pleq në Maqedoni me organizimin e programeve të rastit dhe me pjesëmarrje të të rinjve të Kryqit të Kuq ndërsa personave të moshuar iu dhuruan dhurata rasti, u organizuan edhe akcione për matjen gratis të tensionit të gjakut dhe sheqerit në gjak si dhe u vizituan persona të moshuar të cilët kryesisht jetojnë vet nëpër shtëpitë e tyre me crast iu nda ndihmë humanitare.




## Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë (ZHPB)

Në pajtim me kahjet e përcaktuara për veprim Kryqi i Kuq i RM-së tani më 5 vite me rradhë në kontinuitet po implementon programin për "Zhvillim të përbashkët të bashkësisë" i cili në të vërtetë ka për qëllim që Kryqin e Kuq t'ua ofrojë personave të varfër dhe bashkësisë gjegjësisht të përcaktojë kujt dhe si t'i ndimohet. Grupa qëllimore në bashkësitë e rrezikuara është bashkësia rome, e ekspozuar rrezikut nga varfëria dhe ndasia

e cila kryesisht është e pa punësuar dhe në një nivel të ulët të arsimimit. Ky program zhvillimor ofron metodë të caktuar të punës e cila kontribuon që më mirë të kuptohet rrezikimi, ndihmon të identifikohen kapacitetet lokale si dhe ofron mundësi për ndërtimin e partneritetit me persona të rrezikuar, organizatat joqeveritare, organet dhe institucionet qeveritare dhe ndërmarrjet.

Me këtë program kontribuohet inkuadrimi social dhe funksional i shoqërisë për mbrojtjen e grupeve të margjinalizuara sociale, ngritja e nivelit socio-kulturor të bashkësisë lokale, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe jetës sociale. Në kuadër të prgramit ZHPB u implementuan këto aktivitete:

K Nga ana e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të Kuq të RM-së u caktuan tre OBKK përmes të cilave u realizuan aktivitetet operative të këtij programi: Karposhi, Kavadari dhe Tetova
K U organizuan tre seminare për edukimin e ekipeve të ZHPB-së për vlerësim të përbashkët të shpejtë.
K U organizuan tre puntori për një grup më të madh me përfaqësues të anëtarëve nga bashkësitë më të varfëra.
K U organizua një puntori me të gjitha koordinatorët e gjithsejt 13 organizatave komunale të Kryqit të Kuq të inkuadruara në program.
K U organizuan takime periodike me koordinatorët komunal të programit ZHPB.
K U implementuan tre mikro projekte nëpërmjet të OBKK-së Karposh, Kavadar dhe Tetovë:

**Karposh: bashkësia: "Dame Gruev",** mikroprojekti: "Përkrahja e zhvillimit të fëmijëve të moshës parashkollore dhe shkollore". Qëllimi i projektit ishte të evitohet frika dhe pasojat e mundshme te fëmijtë me hendikep dhe stikmatizim në shkollim për krijimin e bazës së drejtë dhe shëndoshë për inkuadrimin e tyre në procesin arsimor.

**Kavadar: bashkësia: "Strasho Pinxhur"** mikroprojekti: mësimi i shkrim leximit të popullatës në bashkësinë "Strasho Pinxhur". Qëllimi i projektit ishte të zvogëlohet të analfabetizmit dhe ngesa e edukimit të popullatës në planin shëndetësor - social.

**Tetovë: bashkësitë: "Teqe" dhe "Potok"** mikroprojekti: qendrat edukative për të rinj. Qëllimi i projektit ishte që të ngritet niveli i përgjithshëm arsimor dhe të rriten kapacitetet e të rinjve për komunikimin informativ dhe inkuadrimi i tyre aktiv



në bashkësi.

Koordinatori regjional i programit ZHPB nga Federata ndërkombëtare ne Budapest, prej 22 deri 25 shkurt e vizitoi Kryqin e Kuq të RM-së me qëllim që të përcillet dhe të fitohet një pasqyrë e drejtëpërdrejtë në një pjesë të implementimit të aktiviteteve të ZHPB-së programit në Maqedoni.

Delegacioni regjional i Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq -dhe Gjysmëhënës së Kuqe në Budapest prej 20-22 mars organizoi puntori për programin ZHPB, përvojat nga implementimi i deritanishëm në të cilin morën pjesë dy përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së, koordinatori i ZHPB-së dhe sekretari i OBKK nga Kërcova.

Më 20 dhe 21 shtator në Beograd, në organizim të delegacionit regjional të Federatës ndërkombëtare ne Budapest u mbajt një mbledhje për aktivitetet për ndihmë dhe përkrahje të romëve. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të shërbimeve profesionale të Kryqit të Kuq të RM-së dhe organizata e Kryqit të Kuq të qytetit.

Prej 8 deri 10 nëntor në Belgrade në organizim të DR të Federatës ndërkombëtare u organizua puntori për planet e reja të programit ZHPB dhe evaluimit të tij. Në këtë puntori morën pjesë koordinatori i ZHPB i Kryqit të Kuq të RM-së dhe kryetari i Komisionit për veprimtari sociale-humanitare në të cilën u bë prezentimi i aktiviteteve të cilat implementohen në Maqedoni si dhe një pjesë e evaluimit të kryer për këtë program.

## Ndihma e parë psikologjike

Në planin e ndihmës së parë dhe përkrahjes psikologjike gjatë vitit të kaluar u realizuan aktivitete themelore fillestare për personat të cilët do të implementojnë aktivitetet për përkrahjen e grupeve të caktuara qëllimore të popullatës për zvogëlimin e rrezikut gjatë jetës dhe punës së përditshme.

Prej 14-16 shtator në Strugë, në Qendrën për pushim dhe edukim të kuadrove të Kryqit të Kuq u mbajt seminar për edukimin e edukatorëve për ndihmë të parë psikologjike. Në këtë seminar morën pjesë 35 përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të Kuq si dhe 4 përfaqësues të shërbimit profesional të Kryqit të Kuq të RM-së. Për ligjerues në këtë trajnim u angazhuan persona profesional adekuat. Qëllim kryesor për organizimin e këtij seminari ishte




fitimi i njohurive themelore për rëndësinë e përkrahjes dhe ndihmës psikologjike si dhe njohuritë elementare të domosdoshme për aplikimin e tyre kualitativ si parakusht për edukim të mëtutjeshëm me sukses të edukatorëve të cilët do të përforcojnë njohuritë në fazat e mëtutjeshme të stërvitjes së tyre.

Me këtë rast u përgadit një doracak për ndihmën e parë psikologjike dhe përkrahjen gjatë stresit, traumave dhe katastrofave për nevojat e personave që do të edukohen për ofrimin e përkrahjes psikologjike popullatës.

## Lufta kundër tregtimit me njerëz

Tregtimi me njerëz po bëhet problem gjithnjë e më i madh në shoqërinë bashkëkohore dhe paraqet një prej formave më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut. Në Republiken e Maqedonisë tregtimi me njerëz si problem, sidomos viteve të fundit shënon një ngritje, me fillimin e procesit të tranzicionit, krizat në fqinjësi që u reflektuan edhe në vëndin tonë, varfëria dhe papunësia si dhe kriminaliteti në përgjithësi.

Në pajtim me Planin zhvillimor 2006-2010 dhe në kuadër të veprimtarisë sociale- humanitare, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë filloi aktivitete në planin preventiv në luften kundër tregtimit me njerëz që paraqet një prej aktiviteteve programore me prioritet të organizatës.

Gjatë muajit shkurt, gjatë vizitës së Kryqit të kuq të Maqedonisë, zonjusha Sanja Pupaqiq, koordinator i athershëm i ZHPB, u realizuan takime në Organizaten Ndërkombëtare për Migrime (IOM), dhe MPB me temë: "Tregtia me njerëz" me qëllim të prezentimit të aktiviteteve që ndërmirren nga ana e shoqatave kombëtare në Europë si dhe të theksohet iniciativa e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për inkuadrimin në aktivitetet kushtuar luftës kundër tregtimit me njerëz.

Në organizim të Kryqit të Kuq danez më 25 dhe 26 maj në Cavtat të Kroacise u organizua mbledhje vjetore e Shoqatave kombëtare të Evropës për bashkëpunim për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me tregtimin me njerëz në të cilën mori pjesë një përfaqësues nga shërbimi prfesional i Kryqit të Kuq të RM.

Gjatë vitit u realizua një bashkëpunim me institucionet adekuate dhe sektorin joqeveritar që veprojnë në planin e luftës kundër tregtimit me njerëz, për përkrahje dhe inkuadrim të Kryqit të Kuq të RM në aktivitetet preventive si dhe në angazhimet e gjithmbarshme për crrënjosjen e këtij problemi global.

Prej 13 deri 19 nëntor në Zagreb u organizua pjesëmarrje me përfaqësues të shoqatave kombëtare nga Europa Juglindore të cilat punojnë në programet për tregtim me njerëz. Nikoqir i mbledhjes ishte KK i Kroacisë në organizim të KK danez. Në këtë mbledhje mori pjesë përfaqësues i shërbimit profesional të Kryqit të Kuq të RM-së dhe një anëtarë i Komisionit për veprimtari sociale humanitare në të cilin u prezentuan planet e ardhshme për veprim në planin e luftës kundër tregtimit me njerëz.

Më 27 nëntor në qendrën e Kryqit të Kuq u organizua mbledhje informative edukative me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të Kuq me temë: "Lufta kundër tregtimit me njerëz". Qëllimi i mbledhjes ishte të fitohen informata adekuate se cka paraqet tregtimi me njerëz si dhe aktivitete po ndërrmiren në vendin tonë nga ana e subjekteve tjera që paraqet bazën e nisjes për kontribut gjatë veprimeve të mëtutjeshme të Kryqit të Kuq të RM-së në planin e luftës kundër tregtimit me njerëz.

## Bashkëpunimi me institucionet shtetërore, lidhjet, organizatat joqeveritare

Kryqi i Kuq i RM-së gjatë vitit të kaluar për realizimin e aktiviteteve të caktuara në planin social -humanitar realizoi bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, Ministrinë e shëndetësisë si dhe Ministrinë e punëve të brendshme. Gjithashtu bashkëpunimi me institucionet adekuate profesionale shtetërore nuk mungoi dhe gjatë vitit këto aktivitete u zhvilluan edhe me institucionet tjera sociale dhe shëndetësore. Për realizimin e suksesshëm të programit social si dhe me qëllim të përfitimit të një përkrahjeje për zbatimin e aktiviteteve konkrete operative u realizua bashkëpunim edhe me organizata humanitare joqeveritare.

Më 30 qershor në Shkup në organizim të Qendrës kombëtare për arsim permanent - senior, me përkrahje të Help Age International - organizatë ndërkombëtare për ndihmë të personave të moshuar u organizua takim konsultativ me OJQ-të që veprojnë në planin e ndihmës dhe kujdesit për persona të moshuar. Në takim mori pjesë një përfaqësues i shërbimit profesional në të cilin u prezentuan aktivitetet për ndihmë dhe kujdes për personat e moshuar dhe u identifikuan aktivitetet që ndërrmiren nga ana e Kryqit të Kuq.

Më 14 dhe 15 dhjetor në hotelin Kontinental në Shkup u organizua Konferencë kombëtare me moton: "Shërbimet në vendbanime për personat me pengesa intelektuale- perspektivat në të ardhmen" në organizim të Qendrës republikane për përkrahje të personave me të meta intelektuale - POROSIA. Në këtë konferencë morën pjesë dy përfaqësues të shërbimit profesional të Kryqit të Kuq të RM-së dhe një përfaqësues i organizatës së Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit.

# GATISHMËRIA DHE VEPRIMI GJATË KATASTROFAVE



Me programin për punë për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2006 u implementuan një numër i madh i aktiviteteve.

Në gjysmën e parë të vitit u mbajtën pesë seminare në organizata komunale të Kryqit të Kuq të Berovës, Kratovës, Kriva Pallankës dhe Negotinës në të cilat morën pjesë përfaqësues të Kryqit të Kuq, Njësisë së vetqeverisjes lokale (NJVL), njësitë rajonale të ministrive, Qendrës për menaxhim me krizat (QMK), Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim (DMSH), me crast u prezentuan kapacitetet dhe aktivitetet e shoqatës kombëtare në rast të situatave emergjente.

Gjatë vitit 2006 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Ministrinë e vetqeverisjes lokale dhe Shoqatën e njësive të vetqeverisjes lokale me përkrahje finansiare nga Komiteti ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq organizoi tre seminare dy ditore për përfaqësues të të gjitha 86 njësive të vetqeverisjes lokale në RM me teminë roli i KK-së në sistemin e mbrojtjes dhe shpëtimit në RM. Përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së prezentuan resurset njerëzore dhe materiale e teknike, aktivitetet në fushën e katastrofave në vend dhe jashtë si dhe detyrat e KKRM-së para, gjatë dhe pas katastrofave.

Mbledhja e rregullt e koordinatorëve kombëtarë për menaxhim me katastrofat u mbajt në pril të vitit 2006 në Caftat të Kroacisë. Shoqata jonë kombëtare u përfaqësua nga një përfaqësues me crast u diskutua për planet për përkrahje të ndërsjellë të shoqatave kombëtare nga Europa qendrore në fushën e gatishmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave.

Në maj të vitit 2006 në Strugë u organizua trajnim për ekipet për përgjigje regjionale gjatë katastrofave. Në kuadër të trajnimit u mbajt seminar për instruktorë për shpëtim nga uji ndërsa në lokalitetet Matka dhe Kodra e Diellit u mbajt kurs veror dhe dimëror për shpëtim në male.

Gjatë gjithë vitit 2006 u punua për realizimin e projektit "Ngritja e ndërgjegjes publike te rinia shkollore për mbrojtje dhe vetmbrojtje në rast të katastrofave". Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë, Byronë për zhvillimin e arsimit me përkrahje financiare të Kryqit të Kuq

norvegjez. Aktivitetet u realizuan në dy faza në 28 shkolla të mesme në Shkup. Në fazën e parë u mbajt puntori dy ditore me profesorë të shkollave të mesme në të cilat u trajtuan tema nga fusha e katastrofave të cilat në të ardhmen duhet trajtuar me nxënësit dhe të punësuarit nëpër shkolla. Për nevojat e profesorëve, pjesëmarrës në puntori u hartua një Doracak për vetmbrojtje dhe mbrojtje në rast të katastrofave, u sigurura një numër i madh i materialit punues dhe edukativ, posterë, fllaera, si dhe cd me të gjitha ligjeratat. Në puntori morën pjesë përfaqësues të Ministrisë, Qendrës për menaxhim me krizat dhe KKRM-së të cilat kishin prezentimet e tyre. Në fazën e dytë e cila zgjati deri në fund të vitit 2006 profesorët pjesëmarrës në puntori organizuan ligjerata për të punësuarit dhe nxënësit nëpër shkolla në të cilat i prezentuan




aktivitetet lidhur me përgaditjen e vlerësimeve dhe planeve për evakuim të personelit dhe nxënësve prej shkollave.

Prej 15-18 shtator 2006 në liqenin e Tikveshit në Kavadar u mbajt stërvitje regjionale "Paqësori 2006". Në stërvitjen me scenario të imagjinuar "Konflikti luftarak" morën pjesë 65 aktivist anëtarë të Njësisë për përgjegje gjatë katastrofave nga Negotina, Velesi, Kavadari, Prilepi, Ohri dhe



Njësia republikane për gatishmëri gjatë katastrofave si dhe njëzet përfaqësues të ARM-së (njësia e helikopterëve), MPB, brigada e zjarrfikësve dhe Qendra mjeksore nga Kavadari. Qëllimi i ushtrimit ishte koordinimi i aktiviteteve të Njësisë për gatishmëri gjatë katastrofave të Kryqit të Kuq të RM-së me subjekte tjera që veprojnë në shtet.

Në dhjetor të vitit 2006 në malin Plackovica në Shtip u organizua stërvitje për anëtarët e njësisë për përgjegje ndaj krizave nga ekipet për shpëtim në male, nga organizatat e Kryqit të Kuq të Ohrit, Shtipit, Prilepit dhe NJRPK-së.

Gjatë vitit përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së morën pjesë në aktivitetet ndërkombëtare nga fusha e gatishmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave. Prej 21 -31 maj 2006 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ishte nikoqir dhe organizatorë i puntorisë për anëtarë të rinj, vlerësues në rast të katastrofave e cila ishte e finansuar nga ana e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Në puntori morën pjesë 45 përfaqësues prej më shumë shoqatave kombëtare të vendeve të Europës Juglindore dhe Azisë Qendrore. Për nevojat e puntorisë u organizuan më shumë aktivitete stërvitore me pjesërmarrje të NJVL, përfaqësuesve të ARM-së, Njësisë së helikopterëve të MPB, kapetanisë së Ohrit dhe NJPK pranë Kryqit të Kuq të Ohrit.

Prej 23 deri 30 shtator në Strugë instruktor të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Kryqi i Kuq austriak mbajtën kurs regjional për ujë dhe sanitari. Në kurs morën pjesë 15 përfaqësues të Shoqatave kombëtare të Kryqit të Kuq nga Bullgaria, Shqipëria Bdhe H, Sërbia, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Në periudhën prej 23-29 tetor 2006 në organizim të Federatës ndërkombëtare në Shqipëri u organizua mbledhje e koordinatorëve kombëtarë për katastrofat nga vendet e Europës Juglindore dhe Azisë Qendrore, ndërsa më vonë edhe aktivitete stërvitore për të gjithë anëtarët e RDRT-së në të cilat koordinatorët nacional kishin rolin e supervizorëve.

Koordinatori jonë kombëtarë në periudhën prej 25.02 deri 14.03 2006 me ftesë të Federatës ndërkombëtare qëndroi në Romani me detyrë të ndihmojë Kryqin e Kuq romun për evitimin e pasojave të vërshimeve të cilat në fillim të vitit 2006 përfshinë Romaninë më crast u organizua një seminar për gatishmërinë dhe veprimin në rast të katastrofave në rajonet më të goditura.

Në periudhën prej 17 deri 20 tetor koordinatori republikan u angazhua si ligjerues për gatishmëri dhe veprim në rast të katastrofave për të punësuarit dhe sekretarët e OBKK-së të Kosovës.

Sektori, së bashku me anëtarët e NJRPK-së u angazhua gjatë vërshimeve në Petrovec të Shkupit, zjarreve në pallatet në Shkup, për sigurimin e ujit të pijshëm për qytetarët e Sveti Nikollës dhe për përcjelljen e aktiviteteve tjera të ekipeve të NJRPK-së dhe NJPK komunale duke iu ofruar ndihmë dhe sygjerime.



# INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI




Viti që kaloi pas vete la aktivitete të realizuara me sukses ndërsa u aplikuan edhe shumë risi në planin e informimit dhe komunikimit në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Ky vit u shënua me aplikimin e sistemit komunikues të brendshëm dhe të jashtëm në organizatë. Në të njëjtën kohë bëhet fjalë për aktivitete të cilave iu paraprіu lidhja elektronike e qendrës së KKRM-së me organizatat komunale dhe atë të qytetit të KKRM-së gjë që u tregua mjaft e vlefshme. Me realizimin e këtij aktiviteti do të vazhdohet edhe gjatë vitit 2007 sepse disa prej organizatave komunale akoma nuk kanë kushte teknike të realizojnë këtë projekt. Ky lloj i komunikimit në masë të madhe lehtësoi punën për shkak të mënyrës së shpejtë të këmbimit të informatave.

## Revista elektronike

Si rezultat i këtyre aktiviteteve doli edhe ideja për përgaditjen e një reviste elektronike të Kryqit të Kuq të RM-së e cila u promovua gjatë muajit mars ndërsa deri në fund të vitit 30 numra të kësaj reviste në mënyrë elektronike u distribuan deri te 30 mijë e mail adresa në vend. Ky aktivitet u tregua i dobishëm sepse në mënyrë permanente u përcollën aktivitetet e organizatave komunale dhe të qytetit të Kryqit të Kuq dhe si të tilla u përcollën deri te opinioni më i gjërë.

## Revista e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë "Meridiane Humane"

Ashtu sic ishte paraparë në programin për punë për vitin 2006 revista e Kryqit të Kuq të RM-së "Solidariteti" me vendim të Këshillit ekzekutiv të Kryqit të Kuq të RM-së fitoi emrin e ri "Meridiane Humane" por në masë të madhe iu ndryshua edhe përmbajtja. Revista edhe më tutje në aspektin përmbajtësor duhet të sendërtohet me qëllim që të vij deri te një zgjidhje e cila në të ardhmen mund të komercializohet. Gjatë vitit 2006 u shtypën tre numra të revistës dhe kësaj rradhe u finansuan nga Kryqi i Kuq i Norvegjisë.

Një pjesë e aktiviteteve gjatë vitit të kaluar ishin të lidhura me shënimin e 17 marsit, ditës së formimit të Kryqit të Kuq të RM-së dhe ditës së dhurimit të gjakut ku një pjesë e madhe e aktiviteteve për organizimin e tribinës me temë për dhurimin e gjakut dhe të gjitha ngjarjet tjera me këtë rast ishin pjesë e informimit dhe kontakteve me opinionin.

Aktiviteti i planifikuar për trajnimin e Shërbimit profesional në Qendrën e KKRM-së për informim dhe komunikim u realizua në muajin maj të vitit 2006. Prej përfundimit të seminarit doli ideja që trajnimet e këtilla të praktikohen edhe më tutje.

Me rastin e aktiviteteve tradicionale të Kryqit të Kuq të RM-së i tërë materiali propagandues u shtyp dhe distribua me kohë deri te organizatat e Kryqit të Kuq. Në pjesën e veprimtarisë botuese u shtypën një numër i madh i broshurave dhe doracakeve të cilat më tutje do të shërbejnë për realizimim e aktiviteteve programore të Kryqit të Kuq të RM-së.

Gjatë muajit dhjetor u organizua seminar tradicional me gazetarë në bashkëpunim me KNKK-në në të cilin morën pjesë 18 përfaqëues të mediumeve nacionale dhe lokale. Qëllimi i seminarit ishte që gazetarët të njohtohen me aktivitetet, detyrat dhe rolin e Kryqit të Kuq të RM-së dhe me komponentat tjera të Lëvizjes.

Gjatë tërë vitit kishte kontakt të përhershëm me mjetet e informimit publik me qëllim të promovimit, transparencës dhe devotshmërisë për realizimin e aktiviteteve të Kryqit të Kuq deri te opinioni më i gjërë me qëllim të përforcimit të imazhit të shoqatës kombëtare.





# TË RINJTË E KRYQIT TË KUQ

Të rinjtë e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë si një ndër bartësit e aktiviteteve të gjithmbarshme në organizatë dhanë kontribut aktiv për realizimin e programeve të përcaktuara. Gjatë vitit u realizuan këto aktivitete:

Me iniciativë të Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit në muajin janar u mbajt seminar për trajnimin e liderëve të rinj në të cilin morën pjesë njëzet vullnetarë nga Shkupi. Pjesëmarrësit e këtij seminari fituan njohuri dhe shkathtësi si t'i organizojnë të rinjtë, si të organizojnë aktivitete dhe punë ekipore. Pas përfundimit të trajnimit ata janë të obliguar të realizojnë detyra të caktuara në organizatat e tyre komunale prej ku më të mirët dhe më të ndërgjegjshmit u shpërblyen me pjesëmarrje në kampin ndërkombëtarë për të rinj me moton "Të jemi një dhe të punojmë bashkë".

Si pjesë e projektit të përkrahur nga ana e Kryqit të Kuq finlandez, një delegacion pesë anëtarësh e vizitoi Kryqin e Kuq të Finlandës gjatë periudhës prej 8-13 shkurt. Në këtë vizitë studimore u prezentuan programet e të rinjve dhe mundësia për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

